

VENDIM
Nr. 754, datë 13.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 408, DATË 8.5.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DËMSHPËRBLIMIN PËR KAFSHËT E ELIMINUARA”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 408, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimi “Drejtoria e Bujqësisë (DB)” zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për veterinarinë në institucionin përkatës”.

2. Pika 8 riformulohet, me këtë përmbajtje:

“8. Procedura për dhënien e dëmshpërblimit për kafshët e eliminuara dhe të groposura, të cilat përmbushin kriteret e pikave 2 e 3, fillon brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga eliminimi dhe groposja e kafshës. Struktura përgjegjëse për veterinarinë, në institucionin përkatës, përgatit dosjen me kopjet e këtij dokumentacioni:

- a) Pasaportën e kafshës që eliminohet dhe matrikullin individual të saj;
- b) Procesverbalin e eliminimit dhe të groposjes, në përputhje me pikën 3, të këtij vendimi;
- c) Sipas rastit, dokumentet veterinarë për zbatimin e masave sanitaro-veterinare në fermë, të urdhëruara nga shërbimi veterinar, në bazë të të cilave është vendosur eliminimi dhe groposja e kafshës;
- ç) Dokumentin që provon shitjen e produktit dhe çmimin, në rastet sipas pikës 13, i cili paraqitet nga pronari i kafshës.”.

3. Në pikën 9, fjalët “... pas marrjes së kërkesës dhe të dokumentacionit të kërkuar nga pronari i kafshës...”, hiqen.

4. Në pikën 11, fjalët “...kërkesës e të...” dhe fjalët “...përgatitet nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në ministri dhe...”, hiqen.

5. Në pikën 17, fjalët “... Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave...” zëvendësohen me fjalët “...Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama